



PROGRAM  
MODULI:

**PRONËSIA  
INTELEKTUALE  
DHE INDUSTRIALE**



# MODULI: PRONËSIA INTELEKTUALE

**Qëllimi:** Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe i mësuesve për konceptet kryesore të pronësisë intelektuale dhe rëndësinë e saj, si një nxitje që çon përpara zhvillimin ekonomik dhe shoqëror dhe lehtëson tregtinë dhe biznesin ndërkombëtar.

**Kohëzgjatja e modulit:** 36 orë mësimore

## I. REZULTATET E PRITSHME TË MODULIT SIPAS TEMATIKAVE

Njohuri	Rezultatet e pritshme	Qëndrime
<p><b>Pronësia Intelektuale (2 orë)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncepti bazë i PI-së.</li> <li>• Arsyeja për mbrojtjen e PI-së.</li> <li>• Degët kryesore të PI-së dhe prezantimi i nën-degëve.</li> <li>• Shembuj dhe raste praktike.</li> <li>• Parimet kryesore operative të PI-së.</li> <li>• Mundësitë për të përfutur dhe përdorur të drejtat e PI-së.</li> <li>• Institucionet kombëtare përgjegjëse për çështjet e PI-së.</li> <li>• Agjencitë ndërkombëtare dhe traktatet përgjegjëse për çështjen e PI-së.</li> <li>• Rritja e rëndësisë së PI-së dhe profesionistëve në këtë fushë.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë rëndësinë e PI-së dhe mënyrat e mbrojtjes së saj (duke e ilustruar me shembuj praktikë dhe raste nga jeta e përditshme);</li> <li>• të bëjë dallimin midis të drejtës së autorit dhe të drejtave që lidhen me të</li> <li>• të bëjë dallimin midis patentave, modeleve të përdorimit, markave tregtare, dizenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe sekreteve tregtare);</li> <li>• të përshkruajë parimet kryesore sesi funksionon e drejta e PI-së;</li> <li>• të dallojë mundësitë që ekzistojnë për të përfituar dhe për të përdorur të drejtat e PI-së;</li> <li>• të përcaktojë institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare që ekzistojnë për format e ndryshme të PI-së;</li> <li>• të dallojë disa nga traktatet më të rëndësishme ndërkombëtare;</li> <li>• të veçojë ndikimet e piraterisë dhe falsifikimit të produkteve tregtare në ekonominë botërore;</li> <li>• të dallojë përgjegjësitë kryesore të avokatëve, të patentave dhe profesionistëve të licensuar dhe certifikuar.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon raste konkrete të shkeljes së pronësisë intelektuale dhe shpreh qëndrimin e tij në mbrojtje të pronësisë intelektuale.</li> </ul>

<p><b>Nxënësi përshkruan Rëndësia e PI-së për rritjen ekonomike (2 orë).</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncepti i ekonomisë së shërbimit.</li> <li>• PI-ja dhe ndikimi në zhvillimin ekonomik (ndikimet pozitive dhe negative).</li> <li>• Administrimi dhe përfitimet nga të drejtat PI-së.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë konceptin e ekonomisë së shërbimit;</li> <li>• të rendisë ndikimet pozitive dhe negative në ekonominë e shërbimit;</li> <li>• të përshkruajë marrëdhëniet midis PI-së dhe zhvillimit ekonomik.</li> </ul>	
<p><b>E drejta e autorit, tregu vendas, kufizimet për të drejtat e autorit dhe zbatimi i tyre (6 orë).</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncepti i mbrojtjes të së drejtës së autorit.</li> <li>• Kushtet për mbrojtjen e autorit.</li> <li>• Si të përftohesh të drejtën e autorit?</li> <li>• Ndryshimet midis krijimit personal dhe punës kolektive.</li> <li>• Përshkrimi i traktateve ndërkombëtare dhe ligjeve vendase për mbrojtjen e autorit.</li> <li>• Përshkrimi i institucioneve kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me të drejtën e autorit.</li> <li>• Përshkrimi i të drejtave ekonomike të autorit.</li> <li>• Përshkrimi i të drejtave morale të autorit.</li> <li>• Kohëzgjatja e të drejtave për të drejtën e autorit.</li> <li>• Transferimi i të drejtës së autorit.</li> <li>• Kufizime mbi të drejtat.</li> <li>• Tregu vendas dhe akses i lirë.</li> <li>• Shkelja e të drejtës së autorit.</li> <li>• Zbatimi i të drejtave.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë çfarë është e drejta e autorit dhe çfarë mbron (Ilustroje me shembuj praktikë);</li> <li>• të përshkruajë kërkesat për të drejtat e autorit;</li> <li>• të dijë parimet e të së drejtës së autorit;</li> <li>• të bëjë dallimin midis të drejtës personale dhe kolektive të autorit;</li> <li>• të përshkruajë shkurtimisht përmbajtjen e ligjeve kombëtare dhe traktateve ndërkombëtare që rregullojnë çështjet e të drejtës së autorit;</li> <li>• të rendisë organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare përgjegjëse për të drejtën e autorit;</li> <li>• të përshkruajë të drejtat ekonomike të autorit dhe t'i lidhë me jetën praktike;</li> <li>• të përshkruajë të drejtat morale të autorit dhe t'i lidhë me jetën praktike;</li> <li>• të dijë sesa zgjat e drejta e autorit në Shqipëri dhe cilat janë kërkesat minimale (ilustro sesi mund t'i përdorin këto të drejta, mbajtësit e të drejtës);</li> <li>• të përshkruajë si mund të transferohet e drejta e autorit dhe si mund të shiten të drejtat ekonomike;</li> <li>• të përshkruajë përjashtimet nga e drejta e autorit;</li> <li>• të përshkruajë licencat e lira alternative, siç parashikohen tek Copyleft and Creative Commons;</li> <li>• të dijë çfarë është plagjiazmi, pirateria dhe pasojat e tyre sipas legjislationit shqiptar.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpreh qëndrimin e tij në raste konkrete të shkeljes së të drejtës së autorit</li> </ul>

<p><b>Të drejtat e lidhura, kufizimet e tyre dhe zbatimet (3 orë).</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Koncepti i të drejtave të lidhura dhe mbrojtja e tyre.</li> <li>• Kushtet për të drejtat e lidhura.</li> <li>• Përfituesit e të drejtave të lidhura.</li> <li>• Të drejtat që i jepen përfituesve të të drejtave të lidhura.</li> <li>• Përshkrimi i institucioneve dhe traktateve kryesore që lidhen me të drejtat.</li> <li>• Kohëzgjatja e të drejtave të lidhura.</li> <li>• Kufizime mbi të drejtat e lidhura.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë se cilat janë të drejtat e lidhura dhe çfarë mbrojnë (ilustro me shembuj praktikë);</li> <li>• të përshkruajë kërkesat për të drejtat përkatëse;</li> <li>• të përshkruajë përfituesit e ndryshëm të të drejtave të lidhura dhe të drejtave që i janë dhënë;</li> <li>• të përshkruajë përmbajtjen e ligjeve të vendit dhe traktateve ndërkombëtare që rregullojnë të drejtat e tjera të dhëna;</li> <li>• të rendisë organizatat vendase dhe ato të huaja përgjegjëse për të drejtat e lidhura;</li> <li>• të përshkruajë me shembuj sesa zgjasin të drejtat në Shqipëri dhe cilat janë kërkesat</li> <li>• të përshkruajë përjashtimet nga të drejtat e lidhura.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon, me shembuj, si mund të mbrojnë dhe përdorin të drejtat mbajtësit e tyre.</li> </ul>
<p><b>Patentat, modelet e përdorimit dhe varietet e bimësisë (9 orë)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Parathënie për shpikjen dhe shpiksin.</li> <li>• Një pamje e përgjithshme dhe qëllimi i të drejtave të patentave (përfshi modelet e përdorimit).</li> <li>• Ndryshimet midis patentave dhe modeleve të përdorimit.</li> <li>• Kushtet për patentueshmërinë.</li> <li>• Përjashtimi nga patentueshmëria.</li> <li>• Të drejtat ekskluzive që i jepen një patente.</li> <li>• Përshkrimi i institucioneve kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe traktatet që lidhen me patentat.</li> <li>• Kërkimi patentave.</li> <li>• Shkelja e të drejtave të patentave.</li> <li>• Zbatimi i të drejtave të patentave.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë se cilat janë të drejtat e patentave dhe çfarë mbrojnë (Ilustro me shembuj praktikë);</li> <li>• të bëj dallimin midis patentave dhe modeleve të përdorimit;</li> <li>• të rendisë kushtet e përgjithshme më të njohura për patentueshmërinë;</li> <li>• të rendisë të drejtat ekskluzive që ka një patentë;</li> <li>• të rendisë përjashtimet nga patentueshmëria;</li> <li>• të përshkruajë ku të drejtohet në rast të një shpikjeje të re;</li> <li>• të gjejë burimet paraprake për të bërë kërkimin për patentë;</li> <li>• të analizojë pasojat e mundshme në rastet e shkeljes së patentës në rang kombëtar dhe ndërkombëtar;</li> <li>• të deklarojë se kush është përgjegjës për zbatimin e patentave;</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kërkon raste të shkeljes së patentës dhe shpreh qëndrimin e tij në lidhje me të</li> </ul>

<p><b>Dizenjot Industriale (2 orë)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një pamje dhe qëllimi i dizenjove industriale.</li> <li>• Dallimet midis dizenjove të regjistruara dhe jo të regjistruara.</li> <li>• Kërkesat për dizenjot industriale.</li> <li>• Përjashtimi nga dizenjot industriale.</li> <li>• Të drejta ekskluzive që jepen me dizenjot industriale.</li> <li>• Përshkrimi i institucioneve kryesore dhe traktateve që lidhen me dizenjot industriale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</li> <li>• Shkelja dhe zbatimi i të drejtave industriale.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë cilat janë dizenjot industriale dhe çfarë mbrojnë (ilustro me shembuj praktikë);</li> <li>• të rendisë kushtet e përgjithshme të njohura të dizenjove industriale;</li> <li>• të rendisë të drejtat ekskluzive që jepen nga dizenjot industriale;</li> <li>• të rendisë përjashtimet nga dizenjot industriale;</li> <li>• të përshkruajë mënyrat e mundshme sesi mund të mbrohen të drejtat për dizenjo industriale;</li> <li>• të përshkruajë ku mund të drejtohen në rast të një dizenjoje të re industriale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;</li> <li>• të parashikojë pasojat e mundshme në rast të shkeljes së dizenjove në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpreh qëndrimin e tij kundër një rasti të shkeljes së dizenjos industriale në komunitetin ku jeton.</li> </ul>
<p><b>Markat tregtare (MT), përcaktimi i emërimit të origjinës (EO), treguesit gjeografikë (TG) (8 orë)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Parathënie për MT, EO, TGj dhe emrat lokalë.</li> <li>• Qëllimi dhe ndërlidhja midis MT, EO, TGj.</li> <li>• Dallimet midis MT, EO dhe TGj-së.</li> <li>• Kushtet për MT, EO dhe TGj-së.</li> <li>• MT, EO dhe TGj të paregjistrueshme.</li> <li>• Të drejtat ekskluzive që jepen për MT-të, EO-të, TGj-të.</li> <li>• Llojet e ndryshme të MT-ve.</li> <li>• Klasifikimi MT-ve.</li> <li>• Përshkrimi i institucioneve kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe traktatet që lidhen me MT-të, EO-ve dhe TGj-ve.</li> <li>• Shkelja dhe zbatimi i MT-ve, EO-ve dhe TGj-ve (shembuj).</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të rendisë dhe përshkruajë, me shembuj praktikë, shkurtimisht ato elemente që shërbejnë si MT, EO, TGj;</li> <li>• të bëjë dallimin, me shembuj praktikë, midis MT-ve, EO-ve, TGj-ve;</li> <li>• të rendisë kushtet e përgjithshme të njohura të MT-ve, EO-ve, TGj-ve;</li> <li>• të analizojë llojet dhe klasifikimet e ndryshme të MT-së;</li> <li>• të bëjë dallimin midis markave kolektive dhe markave të certifikuara;</li> <li>• të përshkruajë cilat MT, EO, TGj nuk janë të regjistrueshme;</li> <li>• të rendisë të drejtat ekskluzive që jepen me MT;</li> <li>• të përshkruajë ku të drejtohet në rast të regjistrimit të një MT-je, EO-je dhe TGj-je të re;</li> <li>• të përshkruajë pasojat e mundshme në rast shkeljeje.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmerr veprime praktike në mbrojtje të të drejtave që lidhen me markat tregtare</li> </ul>

<p><b>Sekretet tregtare (2 orë)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një pamje e përgjithshme për sekretet tregtare.</li> <li>• Përcaktimi i statusit të sekreteve tregtare.</li> <li>• Përshkrimi i institucioneve kryesore, legjisllacionit dhe traktateve që lidhen me sekretet tregtare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</li> <li>• Shkelja dhe zbatimi i sekreteve tregtare</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përcaktojë dhe përshkruajë statusin e sekreteve tregtare (ilustro me shembuj praktikë);</li> <li>• të rendisë ligjet, traktatet dhe institucionet që lidhen me sekreteve tregtare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;</li> <li>• të dijë për pasojat e mundshme në rastin e shkeljes së sekreteve tregtare;</li> <li>• të diskutojë për shembuj të shkeljes dhe zbatimit të sekreteve tregtare (ilustro me raste nga jeta e përditshme).</li> </ul>	
<p><b>Konkurrenca e pandershme (2 orë)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Një pamje e përgjithshme për konkurrencën e pandershme</li> <li>• Llojet e ndryshme të konkurrencës së pandershme.</li> <li>• Përshkrimi i institucioneve kryesore, legjisllacionit dhe traktateve që lidhen me konkurrencën e pandershme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</li> <li>• Shkelja dhe zbatimi në rastet e konkurrencës së pandershme.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përcaktojë dhe përshkruajë konkurrencën e pandershme (ilustro me shembuj praktikë);</li> <li>• të rendisë ligjet, traktatet dhe institucionet që lidhen me konkurrencën e pandershme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;</li> <li>• të përshkruajë për pasojat e mundshme në rastin e konkurrencës e pandershme;</li> </ul>	

## II. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E MODULIT

### a. Ku mund të zhvillohet ky modul?

- Moduli i plotë sugjerohet të zhvillohet **në arsimin e mesëm**. Ai mund të zhvillohet i plotë, si modul me zgjedhje ose i integruar, sipas rastit dhe mundësive, në lëndën Qytetaria për klasën 10-të, në kapitujt që trajtojnë ligjin, të drejtat e njeriut, medien, korrupsionin, ekonominë etj.
- Tema të veçanta të tij mund të integrohen edhe në arsimin bazë, kryesisht në lëndën qytetaria, sa herë që trajtohen të drejtat e njeriut dhe përgjegjësitë. Po kështu, ai mund të trajtohet sa herë që fokusi i mësimdhënies është përgjegjësia morale në shoqëri, lufta kundër korrupsionit, çështjet ekonomike, sipërmarrja etj. Mësuesi i lëndës Qytetaria për arsimin bazë duhet të përshtatë mësimdhënien (njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e pritshme) në përputhje me moshën dhe tematikën e trajtuar.

### b. Pedagogjia

Për realizimin e modulit, për të promovuar në shkollë PI-në dhe të drejtën e autorit, mësuesit duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur diskutimet, debatet, punën në grupe, veprimtaritë konkrete dhe projektet. Kjo formë mësimdhënieje i ndihmon nxënësit t'i zbatojnë lehtësisht njohuritë në praktikë.

Realizimi i mësimin ka rëndësi parësore për arritjen e rezultateve të parashikuara të nxënësit. Për këtë sugjerohet që mësuesi të planifikojë mësimin, duke mbajtur parasysh rezultatet mësimore të parashikuara në programin e modulit.

Kërkimet për patenta duhet të demonstrohen në salla të pajisura me kompjuter personal. Rekomandohen vizita në zyrat e patentave dhe institucioneve që lidhen me PI-në. Mësuesi duhet të përpiqet të lidhë aspektet e ndryshme të PI-së me lëndë të tjera dhe ta ilustrojë me shembuj praktikë

## III. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR REALIZIMIN E MODULIT

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Shembuj të printuar të patentave kombëtare, modeleve të përdorimit, markave tregtare dhe dizenjove industriale.
- Orë për kompjuter, pajisur me kompjuter personal, mundësisht një kompjuter për çdo nxënësi) dhe akses në internet.
- Projektor (bimer).







**IGE | IPI**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO**

Publikimi u mundësua nga projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale, një projekt i Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) i zbatuar nga Zyra Federale Zvicerane për Pronësinë Intelektuale.